

LIGJI Nr. 05/L -042

PËR RREGULLIMIN E SHËRBIMEVE TË UJIT

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR RREGULLIMIN E SHËRBIMEVE TË UJIT

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë dhe themelimin e Autoritetit rregullator për shërbimet e ujit "në tekstin e mëtejshëm (Autoriteti)".

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj zbatohet për të gjithë ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe të furnizuesve të ujit me shumicë në Kosovë" në tekstin e mëtejshëm (ofruesit e shërbimeve)"

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Autoriteti** - Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit (ARRU) si autoritet i pavarur, përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit në Kosovë. i themeluar me këtë ligj;

1.2. **Furnizues i ujit me shumicë** - çdo ofrues i shërbimit që ka licencë të shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të përpunuar ose të papërpunuar;

1.3. **Kartë e konsumatorëve** - dokumenti që u jepet konsumatorëve nga ofruesit e shërbimeve, e cila është e bazuar në rregulloret e lëshuara nga Autoriteti, i cili në mënyrë të qartë thekson të drejtat dhe obligimet e ndërsjella mes konsumatorit dhe ofruesit të shërbimeve, lidhur me shërbimet e ofruara;

1.4. **Kthimi në kapital** - kthimi i bazuar dhe i arsyeshëm në vlerën e investimeve të bëra nga ofruesi i shërbimeve dhe/ose pronari/ët e tij;

1.5. **Komunë** - Njësi administrative e përcaktuar sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale;

1.6. **Konsumator** - Personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve dhe/ ose merr shërbime nga ofruesi i shërbimeve;

1.7. **Kontrata e shërbimit** - kontrata standarde e cila lidhet mes ofruesit të shërbimeve dhe konsumatorit, i cili rregullon ofrimin e shërbimeve, të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese;

1.8. **Komisionet këshilluese të konsumatorëve** - komisionet e përshkruara dhe të themeluara në pajtim me nenin 26 të këtij ligji;

1.9. **Lidhje e autorizuar** - lidhja në mes të objekteve të konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, të ofruara nga ofruesi i shërbimeve në pajtim me këtë ligj;

1.10. **Lidhje e paautorizuar** - lidhja në mes objekteve të konsumatorit dhe rrjetit shpërndarës për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura që nuk është kryer nga ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura dhe në pajtim me ligjin;

1.11. **Licencë e shërbimit** - leje e lëshuar nga Autoriteti me të cilën jepet autorizimi për ofrimin e shërbimit të ujit;

1.12. **Marrëveshje për pagesë** - marrëveshje e lidhur ndërmjet ofruesit të shërbimeve të ujit dhe konsumatorit për pagesë të borxhit që ka konsumatori ndaj ofruesit të shërbimeve;

1.13. **Ofrues i shërbimeve** - çdo ofrues i shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizuesit të ujit me shumicë;

1.14. **Paralajmërim** - njoftim me shkrim që i është dhënë ofruesit të shërbimeve nga Autoriteti në pajtim me nenin 40 të këtij ligji;

1.15. **Përsoni** – përson fizik apo juridik i cili mund të jetë publik apo privat;

1.16. **Përson i cenueshëm** - çdo person fizik, jeta ose shëndeti i të cilit konsiderohet të jetë në rrezik, në mungesë të shërbimeve të ujit, me kusht që ky fakt të konfirmohet nga mjeku i licencuar ose cilido konsumator që nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale konsiderohet si person i varfër, i cili rast iu është bërë me dije ofruesve të shërbimit të ujit se gëzon të drejtën që faturat e tij të paguhen nga organet kompetente të mirëqenies sociale;

1.17. **Konsolidimi- procesi** i ristrukturimit të sektorit për konsolidimin e ofruesve të shërbimit;

1.18. **Rregulloret** - legjisllacioni sekondar që nxjerr Autoriteti;

- 1.19. **Standardet e shërbimit** - nënkuptojnë standardet e shërbimit që zbatohen për atë shërbim në përputhje me legjislacionin aktual;
- 1.20. **Shërbimet e ujit** - shërbimet e ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizimi i ujit me shumicë;
- 1.21. **Shërbimet e ujësjellësit** - marrja, përpunimi dhe shpërndarja e ujit për konsum njerëzor si dhe operimi i rrjetit dhe objekteve për atë qëllim;
- 1.22. **Shërbimet e ujërave të ndotura** - grumbullimi, bartja, trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të ndotura të përdorura nga shfrytëzuesit shtëpiak, komercial, industrial dhe publik;
- 1.23. **Shërbimet e kanalizimit** - shërbimet në infrastrukturën fizike të cilat shërbejnë për të përcjellur ujërat e ndotura;
- 1.24. **Shërbimet e ujit me shumicë të pa përpunuar** - shërbim i ujit të mbledhur, ose të ekstraktuar i cili si i papërpunuar furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.25. **Shërbimet e ujit me shumicë të përpunuar** - shërbim për ujin e mbledhur, ose të ekstraktuar i cili si i përpunuar furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.26. **Ndërprerje** - ndërprerje e ofrimit të shërbimeve nga ofruesi i shërbimeve për shkaqe të sigurisë, operacionale, mospagesës së faturave nga ana e konsumatorit apo për shkaqe tjera të përcaktuara me këtë ligj;
- 1.27. **Njoftim** - njoftimi për konsumatorë në gjuhët zyrtare për ndonjë aktivitet të caktuar të ofruesit të shërbimeve;
- 1.28. **Tarifa e shërbimit** - vlera, ngarkesa apo tarifa fikse të ofruesit të shërbimeve me të cilën ofruesi i shërbimeve e ngarkon konsumatorin në lidhje me ofrimin e shërbimeve;
- 1.29. **Tarifa për ujin me shumicë** - vlera, ngarkesa për furnizuesin e ujit me shumicë, lidhur me furnizimin e ujit me shumicë për ofruesit e shërbimeve;
- 1.30. **Të dhënat për performancën e shërbimit** - shënimet dhe informacionet e dhëna nga ofruesit e shërbimeve të cilat mbahen dhe dorëzohen nga ofruesi i shërbimeve në pajtim me formatin e përcaktuar nga Autoriteti;
- 1.31. **Uji i pa-faturuar** - uji që mbetet pasi të zbritet uji i shitur prej ujit të prodhuar;
- 1.32. **Uji me shumicë** - uji i përpunuar ose i pa papërpunuar i cili furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.33. **Zona e shërbimit** - rajoni ose komunat në të cilën ofruesi relevant i shërbimeve duhet të ofrojë shërbimet e tij në bazë të licencës së shërbimit

Neni 4

Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit

1. Autoriteti është institucion i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij sipas këtij ligji.

2. Autoriteti është përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të të gjithë ofruesve të shërbimeve.

3. Autoriteti ka kompetencë për:

3.1. licencimin e ofruesve të shërbimeve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit;

3.2. përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e shërbimeve, duke siguruar që tarifat të jenë të drejta dhe të arësyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve;

3.3. vendosjen e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit nga ofruesit e shërbimeve të këtyre standardeve;

3.4. monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimeve për të vlerësuar nëse ata i përmbushin kushtet e përcaktuara me licencën e shërbimit si dhe caqet e përcaktuara me procesin tarifor;

3.5. themelimin dhe mbështetjen e Komisioneve këshilluese të konsumatorëve në shtatë regjionet e Kosovës;

3.6. hartimin dhe miratimin e rregulloreve, standardeve dhe vendimeve rregullatore në pajtim me autorizimet që ka në bazë të këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme;

3.7. inspektimin e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore të Autoritetit.

4. Selia e Autoritetit është në Prishtinë.

Neni 5

Struktura Organizative e Autoritetit

1. Autoriteti e ka drejtorin, zëvendësdrejtorin, kuadrin profesional dhe nëpunësit.

2. Struktura dhe organizimi i Autoritetit rregullohet me akt nënligjor të nxjerrur nga Autoriteti.

Neni 6

Drejtori i Autoritetit

1. Autoriteti udhëhiqet nga drejtori.

2. Drejtori i Autoritetit është përgjegjës për :

2.1. administrimin dhe menaxhimin e Autoritetit;

2.2. organizimin dhe punësimin e personelit, nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe marrjen e vendimeve për çështjet që u përkasin funksioneve të Autoritetit;

- 2.3. menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë besuar Autoritetit;
 - 2.4. menaxhimin e buxhetit të Autoritetit dhe për mënyrën e shpenzimit të tij;
 - 2.5. përfaqësimin e Autoritetit brenda dhe jashtë vendit;
 - 2.6. lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare në pajtim me ligjet në fuqi;
 - 2.7. angazhimin e ekspertëve jashtë Autoritetit;
3. Drejtori i Autoritetit ushtron edhe detyra tjera të përcaktuara me këtë ligj.
 4. Në mungesë të drejtorit, Autoriteti udhëhiqet nga zëvendësdrejtori.

Neni 7

Procedura për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit

1. Komisioni parlamentar përkatës, gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të Autoritetit e njofton kryetarin e Kuvendit për fillimin e procedurës për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të ri.
2. Komisioni shpall konkursin publik për pozitën e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të Autoritetit. Afati për aplikimin e kandidatëve është pesëmbëdhjetë (15) ditë.
3. Kandidatët për drejtor dhe zëvendësdrejtor të Autoritetit duhet të plotësojnë kushtet si në vijim:
 - 3.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
 - 3.2. të ketë së paku diplomë universiteti katër (4) vjeçar ose master;
 - 3.3. të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, mbi gjashtë (6) muaj burgim;
 - 3.4. të ketë integritet të lartë moral;
 - 3.5. të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune menaxheriale.
4. Pas skadimit të afatit të paraparë në paragrafin 2. të këtij neni, Komisioni, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili plotëson kushtet e parapara në paragrafin 3 të këtij neni, për tu zgjedhur drejtor ose zëvendësdrejtor i Autoritetit, dhe në bazë të rezultatit të intervistës, përgatitë listën e ngushtë me nga dy (2) kandidatë për votim në Kuvend.
5. Kuvendi, me votim të fshehtë, zgjedh njërin prej dy (2) kandidatëve të propozuar nga Komisioni për drejtor të Autoritetit dhe njërin prej dy (2) kandidatëve të propozuar nga Komisioni për zëvendësdrejtor të Autoritetit, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm.
6. Drejtori dhe zëvendësdrejtori i Autoritetit zgjidhen për një afat pese (5) vjeçar, me mundësi të

rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.

7. Drejtori dhe zëvendësdrejtori i Autoritetit, gjatë mandatit, nuk mund të ushtrojnë veprimtari politike.

8. Drejtori dhe zëvendësdrejtori i Autoritetit, gjatë mandatit, nuk mund të ushtrojnë detyra tjera publike, për të cilat shpërblehet me pagesë.

Neni 8

Procedura për shkarkimin e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit

1. Drejtori ose zëvendësdrejtori, me propozim të Komisionit parlamentar përkatës, shkarkohen nga Kuvendi, për shkak të dështimit në përmbushjen e mandatit të dhënë më këtë ligj.

2. Drejtori dhe zëvendësdrejtori shkarkohen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, që janë të pranishëm.

Neni 9

Pushimi i mandatit të drejtorit dhe zëvendësdrejtorit

1. Drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të Autoritetit mund ti pushojë mandati në këto raste :

1.1. vdekjen;

1.2. paaftësinë mendore apo fizike;

1.3. dënimin me aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

1.4. interesat e drejtpërdrejta personale, martesore apo familjare në një licencë të dhënë sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve në fuqi;

1.5. përfitimet financiare të marra nga bizneset e rregulluara me këtë ligj;

Neni 10

Raportimi i Autoritetit

1. Autoriteti paraqet raport vjetor të punës për vitin paraprak në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më së voni deri më 31 mars të vitit pasues.

2. Raporti publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës;

3. Në raport përfshihen të gjitha aktivitetet operative dhe financiare të Autoritetit të kryera gjatë vitit paraprak, duke përfshirë të dhënat të hollësishme të treguesve të punës për secilin sektor të rregulluar sipas këtij ligji dhe llogaritë e konsoliduar financiare të Autoritetit për vitin paraprak.

Neni 11

Burimet e financimit

Autoriteti financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 12

Procedura e menaxhimit financiar

Menaxhimi i buxhetit të Autoritetit bëhet në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 13

Buxheti vjetor

Autoriteti, gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të propozim buxhetit të tij vjetor, do t'i përmbushë të gjitha kërkesat e aplikueshme për përgatitjen dhe dorëzimin e buxhetit të përcaktuara në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë për Agjencitë e Pavarura.

Neni 14

Taksat e Autoritetit

1. Ofruesi i shërbimeve i paguan Autoritetit taksën e pakthyeshme për paraqitjen e aplikacionit, në ditën kur aplikacioni për lëshimin ose përtëritjen e licencës për shërbime i është dorëzuar Autoritetit.

2. Ofruesi i shërbimeve i paguan Autoritetit edhe taksën vjetore të licencimit deri në njëpikë pesë përqind (1.5%) e bruto faturimit vjetor të raportuar në pasqyrën e të ardhurave të saja për vitin paraprak. Taksa vjetore e licencimit duhet paguar në dymbëdhjetë (12) këste të barabarta. Kësti i parë duhet të paguhet në ditën e parë të muajit kalendarik pas muajit në të cilin licenca për shërbime i është lëshuar ose përtëritur ofruesit të shërbimeve, kurse secili nga këstet e radhës duhet të paguhet në ditën e parë të secilit muaj pasues kalendarik.

3. Të hyrat nga taksat e Autoritetit derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës..

KAPITULLI II

LICENCA PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE

Neni 15

Licenca për shërbime

1. Asnjë ofrues i shërbimeve nuk mund të ofrojë shërbime në Republikën e Kosovës pa pasur licencë përkatëse për shërbime.

2. Autoriteti nxjerr rregulloren për licenca të shërbimit.

Neni 16

Aplikacioni për lëshimin ose përtëritjen e licencës për shërbime

1. Secili ofrues i shërbimeve aplikon tek Autoriteti për marrjen e licencës për shërbime ose për përtëritjen e licencës për shërbime në formën e përcaktuar nga Autoriteti, së bashku me dokumentet dhe informatat e përmendura në formularin e tillë.

2. Autoriteti ia konfirmon ofruesit të shërbimeve brenda pesë (5) ditëve të punës marrjen e aplikacionit dhe dokumenteve të tjera, si dhe pagesën që e ka bërë te Autoriteti.

3. Autoriteti shqyrton aplikacionin për lëshimin ose përtëritjen e licencës për shërbime brenda afatit prej katërdhjetë e pesë (45) ditëve të punës pas marrjes së aplikacionit. Vendimi lidhur me aplikacionin nxirret pas këtij afati me kusht që të gjitha informatat dhe dokumentet e kërkuara për të marrë vendimin i janë sjellë nga ofruesi i shërbimeve.

4. Autoriteti mund të kërkojë që ofruesi i shërbimeve të paraqesë informata dhe dokumente shtesë lidhur me aplikacionin dhe vendimi lidhur me kërkesën merret nga Autoriteti, pasi të shqyrtohen me kujdes të gjitha informatat dhe dokumentet shtesë.

5. Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë nga Autoriteti përtëritjen e licencës së tij për shërbime vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet ne vijim:

5.1. nëse licenca për shërbime parasheh përtëritjen;

5.2. nëse ofruesi i shërbimeve i është përmbajtur kushteve të licencës për shërbime në të gjitha aspektet materiale dhe

5.3. nëse aplikacioni është paraqitur së paku dy (2) muaj para datës kur skadon licenca për shërbime.

6. Nëse Autoriteti vendos që të refuzoj ose të mos ia përtërijë licencën për shërbime ndonjë ofruesi të shërbimeve, ai e njofton me vendim ofruesin e shërbimeve me shkrim për arsyt brenda dhjetë (10) ditëve të punës.

Neni 17

Licenca për shërbime

1. Licencat për shërbim lëshohet për periudhën jo më të shkurt se një (1) vit dhe jo më gjatë se dhjetë (10) vjet.

2. Autoriteti lëshon dhe përtërinë licencat e shërbimit nëse aplikuesi dëshmon se:

2.1. posedojnë kapacitete profesionale dhe resurse adekuate menaxhuese, operative dhe teknike për operim dhe mirëmbajtje për ofrim të shërbimeve sipas standardeve të shërbimit dhe komerciale,

2.2. ka qëndrueshmëri financiare gjatë tërë kohëzgjatjes së licencës së shërbimit,

2.3. pranon përgjegjësin për ofrim të shërbimeve në tërë zonën e shërbimit të ofruesit e

shërbimit, të përcaktuara me politikat dhe planet e Qeverisë për konsolidimin e ofruesve të shërbimeve,

2.4. u është përmbajtur kushteve të licencës së shërbimit,

2.5. kanë siguruar të gjitha lejet, pëlqimet, autorizimet të nevojshme nga autoritetet përkatëse.

3. Ofruesi i shërbimeve duhet të përmbahet kushteve të licencës së shërbimit në të kundërtën ofruesi i shërbimeve mund të lidhë marrëveshje për kushtet e licencës së shërbimit me autoritetin duke përfshirë ndryshimin, plotësimin dhe zëvendësimin e tyre.

4. Autoriteti mund të revokoj licencën e shërbimit nëse ofruesi i shërbimeve:

4.1. nuk iu ka përmbajtur lejeve, pëlqimeve dhe autorizimeve të nevojshme,

4.2. nuk ka paguar taksat apo/ose gjokat,

4.3. nuk ka evituar shkeljet pas skadimit të afatit të paralajmëimit.

Neni 18

Shqyrtimi i kushteve të licencës së shërbimit

1. Autoriteti në pajtim me këtë ligj i shqyrton kushtet e caktuara të licencës për shërbime në pajtim në datën e përcaktuar për shqyrtim dhe çdo vit në këtë datë ose në ndonjë kohë tjetër që mund të përcaktohet me ndonjë marrëveshje.

2. Autoriteti mund të ndryshojë, plotësojë ose zëvendësojë cilat do kushte të caktuara për licencë për shërbime në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, pas shqyrtimit të këtyre kushteve për së paku tridhjetë (30) ditë pune pas njoftimit me shkrim të ofruesit të shërbimeve. Në njoftim theksohet natyra dhe shtrirja e ndryshimit, plotësimit ose zëvendësimit dhe koha e plotfuqishmërisë.

KAPITULLI III

TARIFAT PËR SHËRBIME

Neni 19

Pajtueshmëria me tarifatat e shërbimit

1. Ofruesi i shërbimeve duhet të faturojë konsumatorët e tij për shërbimet e veta në pajtim me tarifatat e shërbimit të përcaktuara nga Autoriteti në urdhëresën tarifore të shërbimit në pajtim me këtë ligj.

2. Furnizuesi i ujit me shumicë duhet të faturojë ofruesit e shërbimeve për furnizim të ujit me shumicë, në pajtim me tarifatat e ujit me shumicë, të përcaktuara nga Autoriteti në pajtim me këtë ligj.

3. Autoriteti do të nxjerr rregullore, dhe procedura për përcaktimin e tarifave.

Neni 20

Shqyrtimi dhe përcaktimi i tarifave

1. Secili ofrues i shërbimeve ose furnizues i ujit të përpunuar ose të papërpunuar duhet të bëjë kërkesë te Autoriteti në mënyrën e përcaktuar nga ai në pajtim me rregulloret e nxjerra sipas nenit 47 të këtij ligji për miratimin e çdo tarife ose ndryshimeve të ndonjë tarife të miratuar.

2. Autoriteti i cakton tarifat me kërkesë të ofruesit të shërbimeve i miraton ato ose ndonjë ndryshim të tarifave të ofruesit të shërbimeve apo furnizuesit të ujit të papërpunuar pas konsultimit me Komisionin Këshilluese të konsumatorëve.

3. Tarifa ose ndonjë ndryshim i tarifës përcaktohet në përputhje me rregulloret e nxjerra nga Autoriteti në pajtim me nenin 47 të këtij ligji, kurse sa i përket kriterëve të mëposhtme cilado që është e zbatueshme:

3.1. shpenzimet marginale afatgjate për ofrimin e shërbimeve përkatëse dhe ndonjë kriter ekonomik i përshtatshëm që zakonisht zbatohet për llogaritjen e tarifave për shërbime të ngjashme në Bashkimin Evropian;

3.2. efikasiteti i ofruesit të shërbimeve i matur me anë të krahasimit me treguesit kryesorë të përmbushjes së punës të përcaktuar në rregulloret e nxjerra nga Autoriteti në pajtim me nenin 47 të këtij ligji;

3.3. shpenzimet e ofrimit të lidhjes për shërbimet përkatëse janë paguar nga përfituesi i atyre shërbimeve dhe se nuk janë mbuluar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga përfituesit tjerë të shërbimeve nga ofruesi i shërbimeve;

3.4. mjaftueshmëria e tarifës për shërbime për të mbuluar shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes të ofruesit të shërbimeve dhe të ndonjë plani të ofruesit të shërbimeve për shpenzime kapitale nëse ato dokumentohen se janë në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të cilat janë miratuar nga Autoriteti;

3.5. përgjegjësia e institucioneve qeveritare, jo e ofruesve të shërbimeve, për t'iu ndihmuar konsumatorëve me të ardhura të ulëta që t'i paguajnë faturat e tyre;

3.6. nevoja për parashikimin e një tarifë bazë për shërbime e cila llogaritet në shpenzimet e prodhimit e që e mbulon sasinë minimale të ujit që është e mjaftueshme dhe e sigurt për përdorim personal dhe shtëpiak dhe për të parandaluar sëmundjet;

3.7. metoda sipas së cilës ofruesi i shërbimeve propozon caktimin e tarifës për shërbime;

3.8. shkalla deri në të cilën ofruesi i shërbimeve gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) mujore paraprake:

3.8.1. i ka ofruar shërbimet e veta në përputhje me standardet e zbatueshme për shërbime;

3.8.2. i ka plotësuar të gjitha standardet përkatëse për mjedisin të zbatueshme në Kosovë;

3.8.3. i ka zvogëluar sasi të e ujit të pafaktuara dhe të pa shitura;

3.9. taksat që duhet të paguhet nga ofruesi i shërbimeve në pajtim me paragrafin 2. të nenit 14 të këtij ligji; dhe

3.10. tarifa për ujin e papërpunuar e cila merr parasysh shpenzimet e furnizimit të ujit të papërpunuar të ofruesit të shërbimeve përkatës dhe një shkallë të përshtatshme të fitimit për furnizuesin e ujit të papërpunuar.

4. Pas konsultimit me Komisionin këshillues të konsumatorëve, tarifa shqyrtohet nga Autoriteti në përputhje me rregulloret e nxjerra sipas nenit 47 të këtij ligji, çdo vit në datën e caktuar ose të miratuar nga Autoriteti apo në cilëndo kohë tjetër të përcaktuar me ndonjë rregullore ose marrëveshje me ofruesin e shërbimeve ose furnizuesin e ujit të papërpunuar.

5. Objektet e kultit lirohen nga pagesa për shërbimet e ujit, në këtë lirim nuk përfshihen objektet përcjellëse administrative dhe fitimprurëse.

KAPITULLI IV STANDARDET E SHËRBIMIT

Neni 21 Standardet e shërbimit

1. Autoriteti do të nxjerrë rregullore, dhe procedura për standarde të shërbimit;

2. Autoriteti do të përcaktoj standarde të shërbimit të cilat përfshijnë;

2.1. Për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit,

2.1.1. cilësinë e ujit sipas standardeve të përcaktuara nga organet kompetente shëndetësore,

2.1.2. shtypjen e ujit nëpër gypa,

2.1.3. disponueshmëria e furnizimit,

2.1.4. matja e ujit,

2.1.5. afatin për zgjidhjen e ankesave dhe për trajtimin e kërkesave për lidhje në sistemin e ujësjellësit dhe shërbimet e ujit.

2.2. Për ofrimin e shërbimeve të kanalizimit,

2.2.1. shpeshtësia e pastrimit të kanalizimit,

2.2.2. shpeshtësia dhe koha e riparimeve të rrjedhave dhe përmytjeve, për trajtimin e ujërave të zeza.

3. Standardet e shërbimeve shqyrtohen në përputhje me rregulloret e nxjerra sipas nenit 47 të këtij ligji, çdo vit në datën e nxjerrjes së këtyre rregulloreve apo në cilëndo kohë tjetër të përcaktuar me ndonjë rregullore ose marrëveshje sipas paragrafit 4 të këtij neni.

4. Autoriteti mund të lidhë marrëveshje me ofruesin e shërbimeve për të ndryshuar, plotësuar ose zëvendësuar standardet e shërbimeve në pajtim me nenin 47 të këtij ligji, ose për hollësitë e këtyre standardeve të shërbimeve.

5. Ofruesit e shërbimeve mund të kërkojnë përjashtim nga ndonjë standard i shërbimit varësisht nga kushtet të cilat Autoriteti i konsideron si të përshtatshme pas konsultimit me Komisionin këshillues të konsumatorëve.

Neni 22

Përputhshmëria me standardet e shërbimeve

1. Ofruesi i shërbimeve gjatë tërë kohës duhet të jetë në pajtueshmëri me standardet e shërbimit që janë të zbatueshme për shërbime të tij.

2. Autoriteti do të përcaktojë vlerat në të cilat përmbushja e standardeve do të jetë e pranueshme për Autoritetin, në përputhje me nenin 21 të këtij ligji.

KAPITULLI V

STATUTI I KONSUMATORËVE

Neni 23

Karta e konsumatorëve

1. Autoriteti nxjerrë rregulloren për kartën e konsumatorëve.

2. Ofruesi i shërbimeve ofron konsumatorëve kartën e konsumatorëve, të bazuar në rregulloret e nxjerra nga Autoriteti, në pajtim me nenin 47 të këtij ligji, i cili ceke të drejtat dhe obligimet e ndërsjella lidhur me shërbimin e ofruar.

3. Karta e konsumatorëve hartohet në gjuhët zyrtare të Kosovës.

4. Karta e konsumatorëve përgatitet në përputhje me dispozitat e Paktit ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.

5. Secili ofrues i shërbimeve i përmbahet obligimeve të veta të ndërsjellta dhe obligimeve të konsumatorit dhe kontratës për shërbime.

Neni 24

Kontrata për shërbime

1. Secili ofrues i shërbimeve, lidhë kontratë me secilin konsumator ku përcaktohen kushtet e përgjithshme sipas të cilave do t'u ofrohen shërbime konsumatorëve.

2. Secila kontratë për shërbime është në përputhje me kartën e konsumatorëve dhe përpilohet në mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti në gjuhët zyrtare të Kosovës.

Neni 25

Regjistri i konsumatorëve

Secili ofrues i shërbimeve e krijon dhe e mirëmban listën e konsumatorëve të cilët kanë lidhur kontratë për shërbime (regjistri i konsumatorëve) në përputhje me rregulloret e nxjerra nga Autoriteti në pajtim me nenin 47 të këtij ligji dhe e mbron fshehtësinë dhe përdorimin e drejtë të të dhënave që ruhen në regjistrin e konsumatorëve.

Neni 26

Komisionet këshilluese të konsumatorëve

1. Autoriteti nxjerr rregullore, për Komisionin këshillues të konsumatorëve.

2. Autoriteti themelon nga një Komision këshillues të konsumatorëve për secilën zonë të shërbimeve, në bashkërendim me komunën përkatëse dhe ofruesin përkatës të shërbimeve me qëllim të:

2.1. konsultimit të konsumatorëve dhe dhënies së rekomandimeve Autoritetit për ndonjë çështje me rëndësi, përkitazi me ofrimin e shërbimeve;

2.2. marrjes së vendimit lidhur me ankesat e shqyrtuara, të cilat nuk janë trajtuar si duhet nga ofruesi i shërbimeve;

3. Anëtarë të një Komisioni Këshillues të Konsumatorëve janë përfaqësuesit e komunave të cilat janë në kuadër të asaj zone të shërbimit dhe ata emërohen nga Autoriteti në bazë të propozimit të komunave përkatëse.

4. Autoriteti mbështet aktivitetet e Komisioneve këshilluese të konsumatorëve në aspektin material, financiar, administrativ dhe profesionale.

KAPITULLI V I

NDËRPRERJA NGA SHËRBIMET E UJIT

Neni 27

Ndërprerjet e ndaluara

1. Autoriteti nxjerr rregullore për ndërprerje,

2. Asnjë ofrues i shërbimeve të ujësjellësit nuk mund të ndërprejë nga shërbimet asnjë person, përveç se në pajtim me kontratën e shërbimit sipas këtij ligji, apo rregulloret e tjera lidhur me ndërprerjet, të nxjerra nga Autoriteti. Ky ligj dhe rregulloret e tjera të nxjerra nga Autoriteti mbizotërojnë mbi kushtet dhe dispozitat në kontratën e shërbimit në rast të kundërthënieve lidhur me ndërprerjet.

3. Ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit nuk mund të ndërprejë ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit për objektin e personit të cënueshëm.

4. Ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit mund të bëjë ndërprerjen e shërbimeve nëse:

- 4.1. ka mendim të arsyeshëm se vazhdimi i ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për jetën a shëndetin e cilit do personi fizik;
- 4.2. një ndërprerje e tillë kërkohet për qëllime operacionale apo të mirëmbajtjes; ose
- 4.3. kërkesa për ujë e tejkalon ofertën.

5. Ndërprerjet e shërbimeve bëhen, në qoftë se janë ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për largimin e rrezikut ndaj jetës apo shëndetit të personave të rrezikuar të shkaktuar nga ndërprerja e tillë dhe në rastin e paraparë në nënparagrafin 4.3. të këtij neni, që ndërprerje e tillë është bërë vetëm pasi që ofruesi i shërbimeve ka kursyer ujin në dispozicion në mënyrën më të mirë të mundshme në bazë të aftësisë së tij teknike.

Neni 28 **Bazat për ndërprerje**

1. Me kërkesë të konsumatorit, ofruesi i shërbimeve të ujësjellësit bën ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit të ofruara në përputhje me kontratën për shërbime për objektin ku banon konsumatori.

2. Me kërkesë të konsumatorit, ofruesi i shërbimeve bën ndërprerjen e shërbimeve të ujësjellësit të ofruara në përputhje me kontratën për shërbime për objektin pronë e të cilit është konsumatori, por që është i banuar nga personi tjetër, nëse:

- 2.1. banuesi është pajtuar se objekti mund të ndërprehet, apo
- 2.2. është dërguar njoftim për ndërprerje të objekteve të parapara për ndërprerje në përputhje me paragrafin 1. të nenit 29 të këtij ligji.

3. Ofruesi i shërbimeve mund ta ndërprejë konsumatorin nëse:

- 3.1. konsumatori ka shkelur kontratën e shërbimeve, me kusht që konsumatori të ketë qenë i njoftuar për shkeljen e tillë dhe që nuk ka bërë evitimin e saj brenda një kohe të arsyeshme të paraparë për atë qëllim;
- 3.2. konsumatori nuk paguan faturën apo nuk hyn në marrëveshje për pagesë të faturës brenda një muaji kalendarik nga data kur ajo faturë duhet të paguhet;
- 3.3. konsumatori nuk e bën pagesën e kërkuar në pajtim me marrëveshjen për pagesë pas njoftimit dhe pas mundësisë së arsyeshme për bërjen e pagesës së tillë;
- 3.4. objekti është i kyçur në mënyrë të paautorizuara;
- 3.5. konsumatori refuzon ta lejojë përfaqësuesin e ofruesit të shërbimeve, të identifikuar në mënyrë të duhur përmes kartelës me fotografi të tij, të ketë qasje në objektet e tij për të instaluar a lexuar njehsorin apo për të inspektuar ose riparuar cilëndo pasuri të ofruesit të shërbimeve në objektet e konsumatorit;

3.6. ekziston një rrjedhje e jashtme dhe e dukshme në objektin e konsumatorit të cilën konsumatori nuk e ka riparuar apo nuk është marr vesh me ofruesin e shërbimeve për ta riparuar brenda pesë (5) ditëve të punës nga paraqitja e kërkesës me shkrim për ta bërë këtë ofruesi i shërbimeve;

3.7. konsumatori nuk ka paguar paradhënien në afatin e paraparë;

3.8. ka baza të arsyeshme për të besuar se konsumatori ka shfrytëzuar shërbimet e ujësjellësit në kundërshtim me kartën e konsumatorit;

3.9. cilido person ka shfrytëzuar shërbimet e ujësjellësit të ofruara për konsumatorin për qëllim të paautorizuar;

3.10. rrjeti i shpërndarjes së shërbimeve të ujësjellësit është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes së madhe ose të shkatërrimit;

Neni 29

Procedurat e ndërprerjes

1. Njoftimi për ndërprerje dërgohet në gjuhët zyrtare.
2. Ndërprerja bëhet nga së paku dy (2) punëtorë të ofruesit të shërbimeve të identifikuar siç duhet me një kartelë me fotografi të tij apo të saj.
3. Shërbimi i ujësjellësit nuk ndërprehet jashtë orarit të punës apo në ditën e cila nuk është ditë pune.

Neni 30

Lidhjet e paautorizuara

1. Asnjë konsumator nuk mund të lidhet në mënyrë të paautorizuar.
2. Ofruesi i shërbimeve mund të iniciojë procedurë penale në gjykatën kompetente ndaj cilitdo person fizik dhe juridik i cili ka kryer shkelje në bazë të Kodit Penal të Kosovës.

Neni 31

Ri-lidhja e bërë nga ofruesi i shërbimeve

1. Ofruesi i shërbimeve e ri-lidhë objektin e konsumatorit jo më vonë se njëzetekatër (24) orë pasi që konsumatori të ketë paguar të gjitha shumat me kohë ndaj ofruesit të shërbimeve.
2. Cilado ri-lidhje e mëvonshme e objektit, qoftë me kërkesë të konsumatorit apo të ndonjë personi tjetër, trajtohet si lidhje e re dhe nuk e liron konsumatorin paraprak nga detyrimet, përkritazi nga shumat e papaguara ndaj ofruesit të shërbimeve.

Neni 32

Ri-lidhjet e paautorizuara dhe manipulimi me ujmatës

1. Asnjë person tjetër përveç ofruesit të shërbimeve i cili e ka bërë ndërprerjen e një konsumatori nga shërbimet e ujësjellësit, nuk ka të drejtë të bëjë ri-lidhjen e atij konsumatori në shërbimet e ujësjellësit.
2. Në rast se një konsumator pasi të jetë ndërprerë nga shërbimet e ujësjellësit ri-lidhet në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni, ai konsumator do të konsiderohet si person i lidhur paligjshëm. Ofruesi i shërbimeve pas zbulimit të ri-lidhjes së paautorizuar do të zbatojë dispozitat e parapara me nenin 30 të këtij ligji, që janë të aplikueshme për lidhjet e paautorizuara.
3. Asnjë person tjetër përveç ofruesit të shërbimeve nuk ka të drejtë të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet për matjen e ujit të konsumuar, qoftë ata të vendosur në sipërfaqe publike apo në objektin e konsumatorit.
4. Në rast se një konsumator vepron në kundërshtim me paragrafin 3 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve ka të drejtë ta ndërprejë atë konsumator nga shërbimet e ujësjellësit dhe të iniciojë procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente.
5. Ofruesi i shërbimeve ka të drejtë t'i faturojë atij konsumatori edhe dëmin financiar që vlerëson, pas konsultimit me Autoritetin se i është shkaktuar si pasojë e manipulimit me ujmatës.
6. Ofruesi i shërbimeve mund t'i konfiskojë të gjitha pajisjet për shërbimet e ujësjellësit, duke përfshirë të gjitha pajisjet për matjen e ujit të përdorura në objektet të cilat në vazhdimësi rilidhen në shërbimet e ujësjellësit në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 33

Tarifat dhe kompensimet për shërbime

1. Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë pagesën e tarifave dhe kompensimet për shërbime, në shumat e përcaktuara nga Autoriteti sipas urdhëresës tarifore të shërbimit.
2. Në rastin kur ofruesi i shërbimeve nuk iu përmbahet procedurave të ndërprerjes të parapara me nenin 29 të këtij ligji, ose me rregulloret e nxjerra nga Autoriteti, çdo konsumator i prekur ka të drejtë për kompensim adekuat, siç përcaktohet kohë pas kohe nga Autoriteti.

Neni 34

Ankesat e drejtuara komisionit këshillues të konsumatorëve

1. Cilido konsumator i prekur nga ndërprerja ndaj të cilit nuk është vepruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ose ndaj të cilit ofruesi i shërbimeve ka bërë shkelje të parapara në kartën e konsumatorëve dhe kontratën e shërbimit, mund ti parashtrojë ankesë ofruesit të shërbimeve i cili ka bërë ndërprerjen.
2. Nëse konsumatori i cili i ka parashtruar ankesë ofruesit të shërbimeve në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, nuk beson që ankesa e tij është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme nga ofruesi i shërbimeve brenda një muaji kalendarik nga data kur kjo ankesë ka arritur tek ofruesi i shërbimeve, atëherë ai mund ta referojë çështjen me shkrim te komisioni këshillues i konsumatorëve që gjendet në zonën e shërbimit për ta zgjidhur.

Neni 35

Marrëveshjet për pagesë

1. Konsumatori i cili nuk ka paguar faturat që i ka borxh ofruesit të shërbimeve mund të kërkojë në përputhje me rregulloret e nxjerra nga Autoriteti, që me ofruesin e shërbimeve të hyjë në marrëveshje për pagesën e faturave të tilla me këste, me kusht që konsumatori t'i paguajë të gjitha faturat e ardhshme që vijnë nga ofruesi i shërbimeve sapo që atyre t'iu vijë afati i pagesës.
2. Nëse cilido këst i pagueshëm sipas marrëveshjes për pagesë nuk paguhet brenda një muaji kalendarik nga data kur duhet të paguhet kësti i tillë, e tërë shuma e papaguar sipas marrëveshjes për pagesë menjëherë bëhet e pagueshme përpos nëse ka masa të tjera për të cilat është arritur marrëveshja me konsumatorin për të kompensuar këtë mospagesë.
3. Kushtet e secilës marrëveshje për pagesë, të cilën ofruesi i shërbimeve e jep, konfirmohen me shkrim dhe dërgohen në adresën e faturimit të konsumatorit brenda pesë (5) ditëve pune nga ofrimi i marrëveshjes së tillë.

KAPITULLI VII

RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Neni 36

Raportimi

1. Autoriteti mbledhë të dhëna dhe informata, duke mos u kufizuar vetëm në të dhënat financiare, operative dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve, të cilat i nevojiten për të ushtruar përgjegjësitë e tija sipas këtij ligji apo të ligjeve tjera të aplikueshme në vend.
2. Ofruesit e shërbimeve duhet të dorëzojnë tek Autoriteti, raportet mujore, tremujore dhe vjetore me të dhëna, sipas formatit dhe afateve të përcaktuara nga Autoriteti kohë pas kohe.

Neni 37

Monitorimi

1. Autoriteti në vazhdimësi bënë monitorimin e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet e shërbimit të përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji dhe pas verifikimit në vazhdimësi do t'i raportojë nivelet e shërbimeve të arritura gjatë periudhave të shikuara.
2. Në mënyrë që të gjenerojë informacionin e kërkuar për monitorimin dhe vlerësimin e arritjes së përmbushjes së standardeve minimale të shërbimit, Autoriteti përcakton formatin që duhet raportuar nga ofruesi i shërbimit.
3. Autoriteti bënë monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimeve dhe të sektorit në përgjithësi, në mënyrë që të:
 - 3.1. sigurojë funksionimin eficient të ofruesve të shërbimeve, dhe sektorit;
 - 3.2. përcaktoj nivelin në të cilin ofruesit e shërbimeve i përmbushin objektivat e

përcaktuara përmes procesit tarifor;

3.3. identifikojë veprimet korigjuese që mund të jenë të nevojshme për të përmirësuar gjendjen.

4. Për qëllim të monitorimit të performancës, Autoriteti përcakton:

4.1. të dhënat edhe formatin e raportimit nga ofruesi i shërbimit;

4.2. treguesit dhe metodologjinë më efikase për monitorimin dhe vlerësimin krahasues,

4.3. treguesit kyç të performancës si dhe vlerëson peshën e tyre.

5. Autoriteti publikon raporte periodike dhe vjetor të performancës, në të cilin shpaloset në hollësi vlerësimi i performancës siç është specifikuar në paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 38 Inspektimi

Gjatë ushtrimit të detyrave mbikëqyrëse, Autoriteti kryen inspektime përmes personave të autorizuar. Roli, kompetencat dhe detyrat e inspektorit në mënyrë më të detajuar do të rregullohen me akt të veçantë nga Autoriteti.

KAPITULLI VIII DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE ADMINISTRATIVE

1. Autoriteti do të nxjerr rregullore për masat ndëshkuese.

2. Ofruesi i shërbimeve është fajtor për shkelje dhe obligohet të paguajë gjobë administrative nga njëzetmijë (20.000) deri në pesëdhjetmijë (50.000) euro nëse:

2.1. ofron shërbim pa pasur licencën për shërbim,

2.2. i ofron Autoritetit informata të falsifikuara, çorientuese, apo të pasakta duke ndikuar që Autoriteti të lëshojë a të përtëritë licencën për shërbim,

2.3. nuk i respekton kushtet e licencës për shërbim të tij, apo të standardeve për shërbim dhe duke vepruar kështu shkakton rrezik për:

2.3.1. shëndetin apo jetën e njerëzve,

2.3.2. mjedisin, apo

2.3.3. mjetet themelore të nevojshme për ofrimin e shërbimeve,

2.4. furnizon me ujë të papërshtatshëm për përdorim nga njerëzit, ose

2.5. Ndërprenë ofrimin e shërbimit pa ndonjë arsye të pranueshme për Autoritetin.

3. Ofruesi i shërbimeve është fajtor për shkelje dhe obligohet të paguajë gjobën administrative prej pesëmijë (5000) deri në njëzetmijë (20.000) euro nëse:

3.1. përsërit apo shkelë në vazhdimësi obligimet e tij themelore të identifikuar dhe të parapara në rregulloret e nxjerra nga Autoriteti në pajtim me këtë ligj, ose

3.2. në mënyrë të paligjshme diskriminon cilindo person a grup të personave.

4. Ofruesi i shërbimeve është fajtor për shkelje dhe obligohet të paguajë gjobën administrative nga njëmijë (1.000) deri në pesë mijë (5.000) euro nëse:

4.1. nuk i përmbahet dispozitave të këtij ligji në cilat do raste të tjera, pos atyre të parapara me paragrafin 2. dhe 3. të këtij neni apo cilës do rregullore të nxjerrë nga Autoriteti në pajtim me këtë ligj, ose

4.2. kërkon tarifa të cilat nuk janë paraparë dhe miratuar në përputhje me këtë ligj.

5. Pagesa e çfarëdo gjobe administrative për cilëndo shkelje të paraparë në këtë nen, nuk e liron ofruesin e shërbimeve nga obligimi për të evituar shkeljen e tillë a për të kompensuar konsumatorin e dëmtuar në përputhje me këtë ligj, ose cilat do rregullore të nxjerra nga Autoriteti në pajtim me nenin 47 të këtij ligji.

Neni 40

Paralajmërimi

1. Nëse Autoriteti, pas kryerjes së hetimeve të arsyeshme, vie në përfundim se ofruesi i shërbimeve ka bërë shkelje sipas nenit 39 të këtij ligji, ose që licenca për shërbim duhet t'i merret për arsyet e parapara në paragrafin 4. të nenit 17 të këtij ligji, dërgon një paralajmërim për ofruesin e shërbimit:

1.1. lidhur me karakterin e shkeljes të cilën ofruesi i shërbimeve besohet ta ketë bërë, dëshmitë që mbështesin mendimin se një shkelje e tillë është bërë, gjobën administrative dhe pasojat e mundshme të shkeljes së tillë,

1.2. lidhur me arsyet se përse Autoriteti beson që licenca për shërbime duhet të merret dhe rrethanat të cilat justifikojnë marrjen e tillë, nëse nuk evitohen brenda periudhës së specifikuar nga Autoriteti në paralajmërimin me shkrim,

1.3. që Autoriteti mund të gjobisë ofruesin e shërbimeve apo, nëse është e rëndësishme, t'ia merr licencën e shërbimit nëse rrethanat që kanë ndikuar në shkelje, ose të cilat justifikojnë marrjen e licencës për shërbime nuk evitohen brenda kohëzgjatjes së paralajmërimin dhe

1.4. që ofruesi i shërbimeve ka afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune për t'i parashtruar një deklaratë me shkrim Autoritetit përkitazi, me çdo çështje të cilat dëshiron të merren parasysh në mbrojtje të tij, siç janë faktet që zbusin përgjegjësinë e tij dhe ndonjë dëshmi tjetër të rëndësishme.

2. Në fund të kohëzgjatjes së paralajmërimit, Autoriteti lëshon vendimin për ofruesin e shërbimeve, në të cilin ceket si në vijim:

2.1. nëse është bërë shkelja, dhe a ekzistojnë rrethanat që kanë sjell deri te shkelja, dhe a janë evituar ashtu siç kërkohet nga Autoriteti;

2.2. rrethanat që justifikojnë marrjen e licencës për shërbime a janë evituar ashtu siç kërkohet nga Autoriteti ;

2.3. se rrethanat që kanë sjell shkeljen ose justifikimin e marrjes së licencës për shërbime nuk janë evituar ashtu siç kërkohet nga Autoriteti:

2.3.1. shumën e cilës do gjobë administrative dhe afatin e pagesës,

2.3.2. se licenca për shërbime është revokuar.

2.4. të drejtën e ofruesit të shërbimeve për t'ia parashtruar kërkesën brenda një (1) muaji Komisionit shqyrtues për të shqyrtuar vendimin.

3. Çdo gjobë administrative e shqiptuar ndaj Ofruesit të shërbimeve në pajtim me nenin 39 duhet t'i paguhet Autoritetit:

3.1. një (1) muaj pas datës së lëshimit të vendimit nga Autoriteti apo

3.2. nëse Ofruesi i shërbimeve i ka parashtruar kërkesën Komisionit shqyrtues për të shqyrtuar vendimin e tillë, ditën kur Komisioni shqyrtues merr vendimin e tij.

4. Kamata sipas shkallës vjetore prej pesë përqind (5%) llogaritet për çdo shumë të papaguar sipas nenit 39 të këtij ligji dhe i shtohet asaj shume në ditën e parë të secilit muaj.

Neni 41

Komisioni shqyrtues

1 .Ofruesi i shërbimeve mund t'i parashtrojë kërkesë Komisionit shqyrtues për të shqyrtuar çdo vendimi të sjellë nga Autoriteti në pajtim me paragrafin 2 të nenit 40 të këtij ligji, me kusht që kërkesa të jetë bërë me shkrim brenda një (1) muaji nga data e vendimit të Autoritetit. Për t'i ikur dyshimit, urdhëresat tarifore, udhëzimet administrative dhe rregulloret e lëshuara nga Autoriteti në pajtim me këtë ligj, gjithashtu i nënshtrohen shqyrtimit nga ana e Komisionit shqyrtues, nëse ofruesi i shërbimit parashtron kërkesën për një shqyrtim të tillë.

2. Komision shqyrtues përbëhet nga kryesuesi i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, një anëtar i emëruar nga Autoriteti dhe një anëtar i emëruar nga ofruesi i shërbimeve, i cili ka parashtruar kërkesën për shqyrtim.

3. Komisioni shqyrtues miraton procedurën, e cila zbatohet gjatë marrjes parasysh të çështjeve të referuara për komisionin shqyrtues.

4. Pas shqyrtimit të prezantimeve të ofruesit të shërbimeve dhe të Autoritetit, komisioni shqyrtues i jep ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit një vendim të hollësishëm me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve.

5. Autoriteti ofron ndihmën e duhur logjistike e administrative komisionit shqyrtues.

Neni 42

Procedura për zgjedhjen e kryesuesit të komisionit shqyrtues

1. Komisioni parlamentar përkatës, gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të kryesuesit të komisionit shqyrtues e njofton kryetarin e Kuvendit për fillimin e procedurës për zgjedhjen e kryesuesit të ri.

2. Komisioni parlamentar përkatës, shpall konkursin publik për pozitën e kryesuesit të komisionit shqyrtues. Afati për aplikimin e kandidatëve është pesëmbëdhjetë (15) ditë.

3. Kandidati për kryesues të komisionit shqyrtues duhet të plotësojë kushtet si në vijim:

3.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,

3.2. të ketë së paku diplomë universiteti katër (4) vjeçar ose master;

3.3. të mos ketë qenë i dënuar për veprë penale, mbi gjashtë (6) muaj burgim;

3.4. të ketë integritet të lartë moral;

3.5. të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.

4. Pas skadimit të afatit të paraparë në paragrafin 2. të këtij neni, Komisioni parlamentar përkatës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili plotëson kushtet e parapara në parafin 3. të këtij neni, për tu zgjedhur kryesues i komisionit shqyrtues, dhe në bazë të rezultatit të intervistës, përgatitë listën e ngushtë me dy (2) kandidatë për votim në Kuvend.

5. Kuvendi, me votim të fshehtë, zgjedh njërin prej dy (2) kandidatëve të propozuar nga Komisioni parlamentar përkatës për kryesues të komisionit shqyrtues, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm.

6. Kryesuesi i komisionit shqyrtues zgjedhet për mandat tre (3) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.

7. Kryesuesi i komisionit shqyrtues, gjatë mandatit, nuk mund të ushtrojë veprimtari politike.

8. Kryesuesi i komisionit shqyrtues nuk duhet të jetë në mardhënie pune në kompanitë publike të licencuara nga Autoriteti.

9. Kryesuesi i komisionit shqyrtues nuk ka marrëdhënie të rregullt pune dhe kompensimi i tij bëhet në bazë të angazhimit sipas nevojës dhe paguhet nga buxheti i Autoritetit.

Neni 43

Procedura për shkarkimin e kryesuesit të komisionit shqyrtues

1. Kryesuesi i komisionit shqyrtues, me propozim të Komisionit parlamentar përkatës, shkarkohet nga Kuvendi, për shkak të dështimit në përmbushjen e mandatit të dhënë më këtë ligj.
2. Kryesuesi i komisionit shqyrtues shkarkohet me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, që janë të pranishëm.

Neni 44

Pushimi i mandatit të kryesuesit të komisionit shqyrtues

1. Kryesuesi i komisionit shqyrtues, mund ti pushojë mandati në këto raste:
 - 1.1.vdekjen;
 - 1.2.paaftësinë mendore apo fizike;
 - 1.3.dënimin me aktgjykim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - 1.4.interesat e drejtpërdrejta personale, martesore apo familjare në një licencë të dhënë sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve në fuqi;
 - 1.5.përfitimet financiare të marra nga bizneset e rregulluara me këtë ligj;

Neni 45

Shqyrtimi Gjyqësor

1. Çdo ofrues i shërbimeve mund t'i parashtrojë kërkesë gjykates me juridiksion kompetent në Kosovë për shqyrtim gjyqësor të vendimit të komisionit shqyrtues, me kusht që kërkesa e tillë të bëhet brenda një (1) muaji nga data kur ofruesi i shërbimeve është paraqitur me shkrim për vendimin përkatës nga komisioni shqyrtues. Gjatë shqyrtimit të vendimit të tillë, gjykata nuk zëvendëson diskrecionin administrativ të Autoritetit me të vetin.
2. Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë nga gjykata me juridiksion kompetent pezullimin e vendimit të Autoritetit për marrjen e licencës, nëse ofruesi i shërbimeve ka për qëllim të parashtrojë kërkesën për shqyrtim dhe mund të vërtetojë se efektet e marrjes së tillë të licencës nga Autoriteti do të ishin të pariparueshme në rast se vendimi anulohet në periudha të mëvonshme nga komisioni shqyrtues, apo nga gjykata me juridiksion kompetent. Çdo pezullim i tillë përfundon pas marrjes së vendimit nga komisioni shqyrtues a gjykata me juridiksion kompetent ose, nëse ndodh më herët, pas skadimit të periudhës gjatë së cilës ofruesi i shërbimeve duhet t'i parashtrojë kërkesën për shqyrtim komisionit shqyrtues ose gjykatës.
3. Në rast se gjykata vendos se ofruesi i shërbimeve nuk ka qenë fajtor për shkeljen apo e zvogëlon gjobën administrative të shqiptuar më parë ndaj tij, Autoriteti i kthen tërë shumën ose pjesën kryesore të shumës të cilën e ka pranuar si gjobë administrative së bashku me kamatë prej një përqind (1%) në vit.

Neni 46

Komunikata me shkrim

1. Autoriteti i dërgon ofruesit të shërbimeve komunikatën me shkrim me anë të postës ose korrierit, në adresën e fundit që e ka marrë Autoriteti nga ofruesi i shërbimeve.
2. Komunikata me shkrim dërguar ofruesit të shërbimeve, konsiderohet si e pranuar nga ofruesi të shërbimeve relevant brenda pesë (5) ditëve të punës nga data kur Autoriteti mund të dëshmojë se është dërguar.

KAPITULLI IX

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 47

Rregulloret e nxjerra nga Autoriteti

1. Autoriteti në afat prej dymbëdhjet (12) muajve nga dita e hyrës në fuqi të këtij ligji do të nxjerr të gjitha rregulloret dhe formularët të kërkuara sipas këtij ligji.
2. Çdo ndryshim, shtesë apo zëvendësim në rregulloret e nxjerra sipas paragrafit 1 të këtij neni, hyn në fuqi pas konsultimit me palët përkatëse, sipas mënyrës për të cilën është pajtuar Autoriteti dhe ofruesit e shërbimeve.
3. Autoriteti mundet në çdo kohë t'i ndryshojë, t'i shtojë apo t'i zëvendësojë rregulloret dhe formularët e paraparë të nxjerrë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni me kusht që t'i paralajmërojë me shkrim ofruesit e shërbimeve së paku tridhjetë (30) ditë pune më parë. Paralajmërimi i tillë cek karakterin e ndryshimit, të shtesës apo të zëvendësimit dhe datën kur hyn në fuqi.

Neni 48

Shqyrtimi i akteve interne të ofruesve të shërbimeve

1. Autoriteti shqyrton dhe miraton aktet interne të punës së ofruesve të shërbimit nga aspekti rregullativ për tu siguruar se janë në përputhje me legjislacionin.
2. Aktet që duhet të hartohen nga ofruesit e shërbimeve dhe të aprovohen nga Autoriteti, përfshijnë:
 - 2.1. Planet e biznesit;
 - 2.2. Planet e menaxhimit të aseteve;
 - 2.3. Planet afatgjata të investimeve;
 - 2.4. Planet e menaxhimit të thatësisë;
 - 2.5. Planet e furnizimit me ujë në situata të emergjencave;

2.6. Rregulloret dhe procedurat interne të ofruesve të shërbimeve në lidhje me aspektet e veçanta të punës së tyre si:

2.6.1. zgjidhja e ankesave të konsumatoreve;

2.6.2. lidhja e konsumatorëve në shërbime;

2.6.3. matja dhe faturimi;

2.6.4. ndërprerja e shërbimit

Neni 49

Dispozitat kalimtare

1. Drejtori, zëvendës drejtori dhe kryesuesi i komisionit shqyrtues, të cilët janë emëruar sipas ligjit për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave nr. 03/L-086, do të shërbejnë në pozitat e tyre deri në përfundimin e mandatit, me mundësi të rizgjedhjes sipas këtij ligji.

2. Të gjitha rregulloret ekzistuese do të vlejnjë deri në nxjerrjen e rregulloreve në pajtim me këtë ligj.

Neni 50

Dispozitat Shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut 2004/49 për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave si dhe Ligji nr. 03/L-086 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave.

Neni 51

Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -042

14 dhjetor 2015

Shpallur me dekretin Nr. DL-001-2016, datë 05.01.2016 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga